

Viti XI, numri 11/nëntor 2007

# FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



# Të gjithë mund të bëhen kampion

Gjatë viteve në fjalët e mia përshëndetëse në shumë raste kam bërë paralelizëm ndërmjet sportit dhe biznesit tonë – jo rastësisht. Është shumë e gjetur karakterizimi i biznesit tonë me metaforat e marra nga sporti që pasqyrojnë mirë karakteristikat të cilat shërbejnë si shembull edhe në shumë fusha të tjera të jetës. Parimet bazë të jetës së kampionëve tregojnë drejtimin e duhur jo vetëm në botën e sportit, por edhe në ditët e zakonshme të marra me përgjegjësi. Kujdesen për shëndetin e tyre, praktikojnë nga dita në ditë, përmirësojnë atë që është e nevojshme, luftojnë me pasion për qëllimet e tyre, funksionojnë mirë në skuadër, ndjekin udhëzimet e trainerit apo ndihmësit të tyre.



**K**a ndodhur shpeshherë që një sportist, apo edhe një skuadër në një loj sporti ka treguar një rezultat i cili jo vetëm në jetën sportive, por edhe në fusha të tjera ka ndryshuar qëndrimin dhe pikëpamjet e masave të gjera. Këtë e shikojmë edhe në biznesin tonë, kur me karakteristikat e sipërpërmendura entuziazmojmë dhe mësojmë linjat tona të poshtme që rriten vazhdimisht.

Po e sqaroj këtë me një shembull. Kohë më parë, në vitin 1913 në Shtetet e Bashkuara jetonte një djalë i ri, i cili punonte në një fushë tenisi për disa penny. Gjatë gjithë

ditës mbarte pajisjet e zotërinjve që luanin golf, të cilët natyrisht ia bënë të qartë vazhdimisht se sa i parëndësishëm ishte, pasi atëherë golfi ishte me të vërtetë vetëm sporti i të privilegjuarve. Pastaj, rastësisht këtij djalë të ri, Francis Ouimet-it iu dha mundësia të merrte pjesë në garën e njohur US Open. Me para borxh pagoi çmimin e regjistrimit dhe luajti me pajisje të marra borxh, por ky djalë njëzetvjeçar luajti aq bukur, sa që hyri në finale me fituesin gjashtë herë të British Open, Harry Vardon. S'kishte as trainer, as ndihmë, derisa një djalë dhjetëvjeçar, Eddie Lowery, doli nga turma dhe i ofroi ndihmë duke i mbartur me

gjithë dëshirë pajisjet e garës. E imagjinoni dot pamjen, një djalë i ri amator me ndihmën e një fëmije përgatitet të konkurojë me lojtarët më të mëdhenj të golfit në botë. Nuk e dramatizoj shumë kur them se situata më kujton luftën e Davidit me Goliatin.

Tre ditë me radhë vazhdoi gara, në stacionin e fundit të të cilës Francis dhe Harry Vardon u ndeshën për fitoren përfundimtare. Kur ky fillestar mundi kampionin dhe ngriti lart kupën, ndryshoi menjëherë pikëpamja e kësaj fushe sporti, madje edhe qëndrimi i gjithë botës. Njëkohësisht golfi u bë një nga lojrat

më popullore, kalimi i kohës së lirë për shumë njerëz.

Ndonjëherë edhe ne e gjejmë veten në situata si Francis dhe Eddie aty në fushë, por biznesi ynë natyrisht nuk është një Goliat i tmerrshëm, dhe as ne nuk jemi djemë të dobët të cilët mund të luajnë rojin e Davidit. Biznesi ynë është shumë i thjeshtë, por aspak i lehtë. Gjithçka varet nga fakti që a jemi në gjendje ta ndajmë vazhdimisht me të tjerët entuziazmin tonë në lidhje me produktet e shkëlqyera dhe mundësinë e veçantë të biznesit. Nuk duhet ta ndërlikojmë mesazhin: duhet të gjejmë vetëm momentin që t'ua tregojmë të gjithëve produktet dhe mundësinë që ndryshon jetën e secilit, në shtëpi, në kafene apo në çdo takim të organizuar. Kur t'iu mbërrijë mesazhi, do ta falenderoni patjetër.

Shumë prej jush e ushtrojnë në mënyrë profesionale ndërtimin e rritjes, ndërtojnë skuadra të mëdha dhe efektive. Unë për këtë iu falnderoj! Puna e përkushtuar e sjell gjithmonë rezultatin e pritur. Kemi qenë dëshimtarë të shumë historive suksesi në këtë biznes; njerëz, pikërisht si Ju, tashmë shijojnë suksesin e merituar, suksesin që iu pret edhe Ju!

Këtu në Shtetet e Bashkuara nëntori është vendimtar më tepër për shkak të festës së Dhënies së Falenderimeve. Të veprojmë për t'i zgjuar me të vërtetë ndjenjat njerëzore në ditët e zakonshme të biznesit; t'i kushtojmë disa minuta shprehjes së falenderimit tonë me një kartolinë apo telefonatë: Faleminderit! Po afron fundi i vitit, por kanë mbetur edhe disa javë nga viti 2007. Të bëjmë çfarë kemi për të bërë me ndershmëri, të punojmë pa e dhënë veten në finish, dhe të na vijnë në mend Francis dhe Eddie duke qëndruar në fushë në fund të finales. Do të kishin miliona shkaqe që ta humbnin ose edhe të dorëzoheshin, por ata prapë qëndruan në këmbë, u përqëndruan tek qëllimi dhe fituan. Edhe fitorja jonë mund ta ndryshoj botën!

# Ndjenja e përbashkët

Gjatë viteve të kaluara kam parë që kur përfundon një aktiviteti ynë, jo vetëm unë, por edhe mjedisi im rrethues, bashkëpunonjësit e mi distributor mbushen me një ndjenjë të pashpjegueshme, të këndshme dhe pak të veçantë. Shpeshherë kam menduar se cili është burimi i kësaj ndjenje. Baza e njëjtë e qenies së bashku dhe mendimeve tona të përbashkëta përcaktojnë edhe ndjenjat tona të njëjta.

Sidomos pas Holiday Rally-t të Poreçit shumë bashkëpunonjës të mi mbushen me një ndjenjë të këndshme kur mendojnë edhe një moment të vetëm për këtë ekpëriencë të përbashkët. Jemi të shumëllojshëm, secili është i veçantë, prandaj është kaq e bukur krijesa njeri. Por një skuadër më e madhe bashkohet dhe vihet në lëvizje nga një qëllim i përbashkët, një sistem i përbashkët, funksionon si një familje e madhe. E ndjejmë që i përkasim diçkaje, një skuadre të përbashkët të madhe, dhe mendimet, ndjenjat dhe veprimet tona na bashkojnë dhe na vënë në lëvizje në një rrugë të njëjtë, diku e njëjtë, diku e ngjashme, por që mbështetet në baza të përbashkëta, drejt qëllimeve. Kjo është një ndjenjë e këndshme, nëse nuk e ke provuar akoma, atëherë eja në një Ditë Suksesi, në një nga aktivitetet tona, pranoje ftesën dhe kualifikohu për në një Rally, le të jetë ai Rally European, Program Ndarje Profiti, Super Rally, World Rally, apo pikërisht Holiday Rally në Poreç. Njihu me këtë ndjenjë, sepse nëse të arrin edhe ty, atëherë do të qetësohesh, do të jesh i sigurt, i shëndetshëm dhe do të bëhesh anëtar i Skuadrës më të mirë në Botë.

**Përpara FLP Hungari!**



*Michael Pook*



# HOLIDAY RA

# POI



# ALLY 2007, REČ



# Erdhi momenti i shumëpritur

Në muajin korrik dhe gusht punuam shumë bashkë me skuadrën time të vogël, dhe kjo punë këmbëngulëse solli edhe rezultat: nga njëra anë arritëm nivelin e supervisorit, dhe nga ana tjetër u kualifikuam për në Rally. Numëronim me padurim ditët e mbetura deri në nisje.

Më në fund erdhi momenti i shumëpritur dhe bashkë me bashkëshorten time të enjten në darkë në Pecs u ngjitëm në autobusin e nisur nga Szegedi bashkë me njëzet e ca bashkëpunonjësit tanë që mëngjesi i të nesërmes të na përshëndeste në Poreç. Rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme, por shoqëria e mirë na bëri ta harrojmë këtë.

Holiday Rally i sivjetshëm u prit në Hotelin Laguna Albatros, i cili është një hotel me katër yje, 324 dhoma me ajër të kondicionuar dhe palma të shumta në parkun e tij të mrekullueshëm. Ky kompleks ndërtesash ndodhet afërsisht 100 metra nga bregu i detit, por përveç kësaj i kënaq pushuesit edhe me 3 pishinat e tij. Në restorantin e madh me vetëshërbim morrëm një shërbim "all inclusive".

Pasi mbërritëm – pas një shplodhje të shkurtër – u pritëm nga një drekë e bollshme në restorant, kështu që u ulëm të ngopur në serinë e leksioneve që filluan në orën 14, të cilat u mbajtën në pallatin e sportit që gjendej afër hotelit. Nuk e di saktë se sa vetë morrën pjesë në Holiday Rally, por atë e di që ishin 8 autobusa që i transportuan të kualifikuarit në vendin e organizimit dhe shumë të tjerë që erdhën me makina.

Aktivitetin natyrisht e hapi drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz**. Në bllokun e parë **Dr. Edit Revesz**, **Dr. Anna Schmitz** dhe **Dr. Terezia Samu** mbajtën leksion rreth lidhjes së aloe vera-s me shëndetin. Pas kësaj **Agnes Krizso** tregoi se si ishte kur e filloi ajo. Pas leksionit motivues të **Jozsef Szabo**-s kursin e të premtës e mbylli historia e diamantes së dyfishtë **Katrin Bajri** e cila tregoi se si disidoi me një çantë të vetme tre muaj përpara rënies së murit të Berlinit, kurse tani





është fqinje e princit Albert të Monakos. Për relaksim ditën e mbyllëm me një party.

Edhe të shtunën dëgjuam shumë leksione të shkëlqyera. **Aranka Vagasi** përshembull mbajti leksion rreth programeve motivuese. **Istvan Halmi** theksoi rëndësinë e skuadrës. **Adolf L. Kosa** prezantoi karrierën e vet në FLP të ilustruar me shifra. Titulli i leksionit të **Veronika Lomjanski**-t ishte: “Edhe unë isha supervisorë”. **Miklos Berkics** shpjegoi që tre herë 8 është e barabartë me 120, pra s’kemi punë tjetër, veçse të nisim tre grupe të mira supervisorësh të cilat na sjellin nivelin e managerit. Për atmosferën e mirë ndërmjet leksioneve u kujdes këngëtarja **Maja Suput** – me sukses, sepse duke dëgjuar këngët e saj u ngritën në kërcim edhe anëtarët e President’s Club.

Manageri im **Laszlo Toth** më tha të ulemi sa më përpara, sepse në rreshtat e fundit nuk ndihet mirë efekti që të jep aktiviteti. Ia dëgjuam fjalën dhe zumë vend në rreshtin e 7-të. Ishte një ekperiencë e papërshkrueshme të shikoje dhe të dëgjoje nga afër njerëzit që kanë arritur shumë në këtë biznes. Mësuam shumë rreth mënyrës se si mund të bëhemi nga supervisor në manager.

Çfarë na dha Rally përveç mësimit? U rakuam me personat më të shkëlqyer të biznesit, si përshembull **Dr. Erika Tanacs Tombaczne-n**, **Miklos Berkics-in**, **Robert Varga-n**, me disa prej tyre shkëmbyem edhe disa fjalë të cilat përbëjnë një motivim plus për ne.

Mbresa ime më e madhe ishte kur gjatë mëngjesit të shtunën **Miklos Berkics-i** u ul në tavolinë me mua, dhe për gjysëm ore bisedova me rjetndërtuesin më të madh të Hungarisë. Me këtë m’u bë realitet një ëndërr. Për këtë ia vllente të punoje gjithë verës.

Pra, si ishte Holiday Rally? Kjo nuk mund të tregohet, vetëm mund të përjetohet. Më rëngjethet edhe tani mishi kur mendoj për të. Poreçi më dha një motivim i cili me siguri na ndihmon në arritjen e nivelit të mëpasshëm.



**TAMAS GALAMBOS**  
supervisor

# Nisemi në Poreç!

Erdhi dita e madhe, 4 tetor 2007, e enjte, ora 20.00. E dini se ç'do të thotë kjo? Si shpërblim për rendimentin tonë nga FLP-ja marrëm një udhëtim për në Kroaci.

Je takuar ndonjëherë me një kompani të tillë? Kryen punën që të pëlqen dhe për këtë blen me çmim të ulur (ose falas) produkte të mrekullueshme të cilat përmirësojnë gjendjen tënde shëndetësore, të paguajnë për punën e bërë dhe si shpërblim të ofrojnë një udhëtim, shpenzimet e të cilit i mbulon FLP-ja! Ne nuk jemi takuar ndonjëherë me diçka të tillë!

E prisnim me padurim udhëtimin, pasi sponsori ynë **Attila Kūri** dhe babai i tij **Andras Kūri** na kishin treguar shumë rreth tij, pasi kishin marrë pjesë në udhëtim e 2006-ës. Më lejoni që me këtë rast t'i falenderoj ata që ma treguan këtë mundësi, më ndihmuan dhe më ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të mia.

Por është tjetër ta dëgjosh dhe tjetër ta përjetosh diçka! Prandaj po ua ofrojmë edhe juve që nëse nuk e keni plotësuar akoma këtë, atëherë bëheni sa më shpejt, ia vlen!

Imagjinojeni, udhëtuam si yjet. Shoqërues me motorr, trupa sigurimi dhe një radhë makinash që kujdeseshin që të përparonte karvani prej tetë autobusash lluksoz.

Edhe në autobus na kënaqën me shumëllojshmërinë e sanduiçeve të shijshme, UJIN MINERAL SIRONA, dhe një film të shkëlqyer motivues. Ke udhëtuar ndonjëherë kështu? Ne jo!

## **MBËRRITJE, 5 TETOR 2007, ORA 10.**

Nuk u besonim syve! Mbërritëm në një vend përrallor, hotel i mrekullueshëm, palma, lule, det. Dhe kjo s'është gjë fare. E dini se çfarë pritje na u bë? Drejtuesit e lartë të FLP-s, Manager, Senior, Soaring, Safir, Diamant-Safir, Diamant dhe që të përmendim edhe disa emra: **Dr. Sandor Milesz, Jozsi Szabo, Miki Berkics, Dr. Adolf L. Kosa...**, të gjithë ndodhen përpara hotelit, na presin ne,







duartrokašin, gëzojnë. Ata për Ne! Na gëzohen Neve, Supervisorëve! Kjo është një ndjenjë e papërshkrueshme!!!

Kur hyjmë në hotel na presin dhurata të tjera! Marrim bluza të kuqe shumë të bukura të FLP-s, stilolapsa, fletore shënimi dhe çanta shpine. Faleminderit!

Paketim i shpejtë në dhoma, pastaj drejt rrugës së zbulimit. Qëndrojmë në taracën e hotelit dhe shikojmë detin. E gjeni dot se kush vjen drejt nesh? Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz!** Fjalët e tij s'kam për t'i harruar kurrë: „Bukur, apo jo? Shplodhuni, hani, pini, ndijeni mirë veten! E MERITONI, KENI PUNUR PËR KËTË!” Keni dëgjuar fjalët të tilla nga „shefi juaj”? Unë asnjëherë nga asnjëri!!!

Drekë! Restorant madhështor me tavolina suedeze dhe taracë me pamje nga deti. Aty gjendej gjithçka që të dëshiron syri dhe goja. Mishra të pjekur, sallata, makarona, peshq të ndryshëm, djathra, fruta (pjepër në tetor!), akullore, ëmbëlsira, salca, pije freskuese, etj. Të premtën pasdite filluan leksionet: **Dr. Edit Revesz Siklosne, Dr. Anna Schmitz, Dr. Terezia Samu**, në pushim kërcime latine, pastaj **Danijela Ockoljic, Jadranka Kraljic-Pavletic, Agnes Krizso, Jozsef Szabo, Katrin Bajri dhe partneri i saj Pascal Crepieux**. Ajo që morrëm nga ata nuk mund të përshkruhet. Por edhe ju e dini, pasi i keni dëgjuar.

Në mbrëmje një darkë fantastike, pastaj disko me njerëzit e parë të kompanisë. Ke kërcyer ndonjëherë me **Jozsef Szabo-n, Mariann Szeker-in, Eva Keszi Szepne-n, Mihaly Szep-in, Melinda Gulyas-in**? Këtu mund ta bëje!

### **6 TETOR, E SHTUNË**

Pas mëngjesit vijmë përsëri leksione të shkëlqyera. Po përmend përsëri vetëm emrat e lektorëve, pasi ajo që dinë dhe japin mësim ata, përvoja e punës së tyre shumëvjeçare është e pamundur të shkruhet. **Irena Dragojevic, Tibor Elias, Robert Varga, Marija Ratkovic**, pas bllokut të muzikës në pushim erdhën **Tünde Hajcsik dhe Andras Lang, Jozefa Zore dhe Dr. Adolf L. Kosa**. Stilolapsat tona lëviznin me shpejtësi. Pak të turullohur nga leksionet magjepse dhe informacionet e shumta mbajtëm një pushim dreke, dhe

imagjinoni që të gjithë lektorët dhe linja e sipërme hërngri drekë me bashkë ne! Ti ke ngrënë ndonjëherë drekë me „shefin tënd”? Pasdite vazhduan leksionet: **Istvan Utasi, Tünde Ibolya Csaszar, Zrinka Vranes, Istvan Halmi, Aranka Vagasi, Miklos Berkics dhe Veronika Lomjanski.** Ishte magjepse, morrëm shumë forca dhe energji prej tyre! Dhe s'ka ardhur akoma fundi!

Pas darkës përsëri disko me vajza që bënin striptizë dhe djem Chippendale. Me shërbim të plotë! Mund të bëje fotografi me këdo! Të gjithë ishin të dashur, mund të kërkoje këshilla. Mund të bisedoje me të mëdhenjtë jo vetëm rreth biznesit. Psh.: këtu morrëm vesh që **Mariann Szeker-it** i pëlqejnë qentë, dhe që lloji i saj i preferuar është ai që rrisim ne.

Dhe si përfundim më lejoni të falenderoj një çift, **Maria Ollos Keszlerne-n** dhe **Arpad Keszler-in.** Atë dashuri, përkujdes dhe mësim që morrëm nga ata s'kam për ta harruar kurrë. Dhe gjithë këtë pa qenë Manageri ynë, pa qenë linja jonë e sipërme, pra pa asnjë interes. Faleminderit! S'kemi për t'i harruar kurrë ata.

Kurse udhëtimin dhe mundësinë për një jetë me cilësi më të mirë ia falenderojmë FLP-s, s'kemi për ta harruar kurrë! Shfrytëzojeni edhe Ju!!!



**IZABELLA PINTER  
SZABOLCS SZEKERES**





# Me sentimentalizëm rreth Poreçit

Matanë majës! E arritëm bashkë me shoqen time të jetës! Nga 3 Korriku deri më 31 Gusht. Ishte diçka turbo. Mposhtëm vetveten dhe më 4 Tetor u ngjitëm në autobusin që shkonte në Poreç. Pas një rrugë prej 14 orësh, që vë në provë edhe një supervisor – edhe ai njeri është -, të pakësuar në numër, por jo të thyer, mbërritëm në perllë e detit Adriatik. E mira e fitoi shpërblimin e merituar, pasi kur zbrita nga autobusi e gjeta veten mes krahëve të një nga shembujve të mi të mëdhenj. Mos ndodhtë kurrë pritie më e keqe!

Pas një pushimi të vogël erdhi një drekë e bollshme në hotelin me 4 yje Laguna Albatros. Pastaj filloi show. Prezantim produktesh për ata që kishin zënë karriget e ish-akademisë, histori sukseesi që të nxirrnin lot nga sytë, dhe për shplodhje vallëzim. Pastaj salla u pushtua nga fuqia.

Një pushim tjetër i vogël, darkë e bollshme, pastaj një arratisje e suksesshme në qytetin e lashtë me atmosferë veneciane të Poreçit. Fotografime, akulllore, diskutimi i momenteve kryesore të ditës – duke i ndërprerë fjalën njëri-tjetrit. Për të tjerët disko.

E shtuna e tejkaloi gjithë imagjinatën tonë. Përsërita në vetvete thënien klasike: “S’ka gjë të paarritshme”. Me enët e gjakut që më dilnin në qafë bëra premtimin “DO TA ARRIJ!”. Pastaj thosha: “Kjo rrugë të sjell prapë në Poreç, edhe unë do të ndërtoj biznes të madh, mëtej, mëtej, mëtej. Drejt nivelit të Safirit miqtë e mi!” Kaq profesionizëm, njerëzim, pastërti dhe ndershmëri në një vend nuk kisha parë ndonjëherë. Me ne aty ishte edhe Zoti i cili na bekoj, siç u lut edhe një nga të preferuarit e mi në mbyllje të leksionit të tij. Po e them burrash, u përpoqa shpeshherë me lotët në sy. Do doja t’i shtrëngoja dhe t’i puthja duart e lektorëve të të shtunës!

Në banketin e mbrëmjes e mira e fitoi përsëri shpërblimin e merituar. Morrëm shumë fjalë motivuese dhe një fotografi të përbashkët nga të mëdhenjtë. Ne ishim “shoqëria e Safirëve”. Vitin e ardhshëm me ju po këtu! Ai që nuk e beson – edhe ai të kualifikohet vitin e ardhshëm për në HOLIDAY RALLY në POREÇ!

Faleminderit  
**JOZSEF OLAH**  
supervisor





# Rilindja e Poreçit

Na ishte dikur një vajzë e cila kishte gjithçka: shëndet, familje, shtëpi, makinë. Por prapë nuk ishte e lumtur, sepse i mungonte diçka në jetë. Vetëbesimi.

Një ditë të bukur iu dha në jetë një mundësi: një jetë më e mirë, më shumë para, mundësi për të ndihmuar të tjerët dhe një karrierë e madhe. Kjo mundësi quhej *Forever Living Products*. Kjo vajzë vendosi ta shfrytëzojë këtë mundësi dhe ta bëj më të bukur jetën e saj dhe të të tjerëve. Fillimisht çdo gjë funksiononte mirë, por prapë i dukej sikur i mungonte diçka. Për rezultatet e shumta të arritura FLP-ja e shpërbleu vajzën dhe partnerin e saj me një ekskursion. Udhëtuan në Poreç.

Që në autobus u dallua që kompania bën gjithçka që ta ndjenin mirë veten. U pritën me dhurata të shumta në një hotel të mrekullueshëm me katër yje. Dhomë me komfort të plotë, ushqim dhe pije me bollëk, party në mbrëmje, me një fjalë kompania i mbante në pëllëmbë ata dhe 850 njerëzit e tjerë, të cilët gjithashtu shijonin frytin e punës së tyre. Aty ishte çdo njeri i rëndësishëm i këtij rajoni. Erdhën leksionet me nivel të lartë të cilat shkaktuan shpeshherë lot në sytë e vajzës, sepse iu duk sikur lektorët e dinin se me çfarë problemesh luftonte dhe thanë vetëm gjëra që vajzës iu duk sikur i drejtoheshin vetëm asaj. Kur u takua edhe personalisht me lektorët ata e hodhën dorën në shpinë duke i thënë që edhe ajo është e aftë të ecë përpara dhe të mos e nënvleftësojë veten, *“Duhet të guxosh të mendosh gjëra të mëdha. Bëhu shembull i denjë i fëmijës tënde” (Robi Varga)* pasi ndodhet në një vend ku çdo gjë është e dhënë: Mundësia dhe ndihma, pasi s’është asnjëherë vetëm. Rrethohet nga njerëz të cilët duan që edhe ajo të bëhet e suksesshme. *“Vetëm ki besim në vetvete që mund ta bësh. Tregobu e hapur ndaj ndryshimeve, ndrysho vetë, dhe atëherë ndryshon çdo gjë rreth teje.” (Tünde Hajcsik)* Njeriu atë që është në gjendje ta besoj, është në gjendje edhe ta realizoj. Ky është sekret i suksesit të sigurt!

Në këtë kohë vajzës i rrahu fort zemra dhe filloi të mbante shënim pikësynimet e saj të cilat deri tani kishte frikë t’i shkruante në letër, sepse kishte frikë nga zhgënjimi. Erdhi koha e kthimit në shtëpi. Vajza u ngjit





në autobus e rinovuar dhe e mbushur me energji, dhe po çonte në shtëpi dhuratën më të bukur për të cilën udhëtoi deri në Poreč, VETËBESIMIN.

Dhe i ndryshoi jeta.

E dini çfarë është më e bukura në këtë përrallë, që nuk është përrallë, por ngjarje e vërtetë. Më besoni që edhe Ju jeni të aftë për këtë, pasi ndodheni në vendin më të mirë, në FLP.

Prandaj falenderojmë *FLP*-n, sponsoren e saj **Ildiko Püspökyova**-n (S), mentoren **Maria Fabianova**-n (AM), linjën e sipërme **Monika Csakyova**-n (AM), **Katalin Szabo Bogdanne**-n dhe **Ervin Bogdan**-in (M), **Melinda Gulyas**-in (Senior M), si dhe **Eva Keszi Szepne**-n dhe **Mihaly Szep**-in (Soaring M).

Mos harroni që „*Duhet të digjet ai që dëshiron të ndez*” (*Piramis*)

Nga 1 janari 2008 përsëri Holiday Rally Poreč, **edhe Ju mund të ndodheni aty!**

16 tetor 2007,  
Ipolysag, Sllovakia

**ANDREA DHE BELA SOLTESZ (S)**



# Mbresat tona nga Holiday Rally

Erdhi pra dita e shumëpritur. Në 29 janar 2007 u regjistruam së bashku me partneren time Ibolya Unghy. Në fund të shkurtit arritëm nivelin e supervisorit. Në këtë kohë sponsori ynë **Istvan Lantos** na tha të plotësojmë programin motivues Holiday. Nuk e morrëm vesh mirë, kuptuam vetëm se në mes të tetorit na pret një fundjavë e gjatë në Poreç.

Kjo fundjavë e gjatë mbëriti tani. Në 4 tetor, në orën 10, u nisëm me dy makina nga Salgotarjani. Ishim 10 vetë që morrëm rrugën, katër prej nesh kishim plotësuar programin motivues, kurse të tjerët erdhën për të mësuar.

Në datën 5, në orën 8 të mëngjesit mbëritëm në Poreç, po iu them se partnerja ime s'kishte qenë ndonjëherë në bregdet – dhe është 53 vjeç. Tani më në fund e arriti këtë falë FLP-s.

Edhe mbëritja s' ishte diçka e zakonshme, në sallën e hotelit u takuam me **Veronika Lomjanski-n**, e cila na ndihmoi me dashamirësi. Pas zënies së dhomave erdhi surpriza e dytë, pas mëngjesit pimë një kafë, donim të paguanim, por s'na lanë. Ç'është kjo? – pyetëm, pastaj e kuptuam se merrnim një shërbim të plotë. Partneres sime iu veshën pak sytë, e kapërcente me vështirësi emocionin. Shëtitem drejt bregdetit, dhe tha se kjo ishte dëshira e saj në jetë, e kishte vendosur se nuk do të vdiste derisa të shikonte detin. Në këtë kohë linja jonë e sipërme **Ervin Hegedús dhe partnerja e tij Timi** tha se ka edhe shumë







dele që do të shikojmë së bashku. Dhe kështu e lamë.

Rreth leksioneve mund të flasim vetëm në nivel të lartë, sipas nesh vlera e këtyre dy ditëve nuk mund të shprehet me para.

Çfarë përfituam nga këto dy ditë?, po përpiqem ta shpreh me fjalë, por është e vështirë.

- shumë informacione të reja
- vrull të ri për punë
- u njohëm me shumë miq të rinj
- shumë lëndë mësimore
- dashuri
- u njohëm me forcën e kompanisë, mahnitëse!!!
- thjeshtësinë dhe gadishmërinë për të ndihmuar të drejtuesve të lartë
- forcën bashkuese të aktivitetit

Gjërat e sipërpërmendura nuk mund t'i radhis dot sipas rëndësisë, por ndihet deri në fund DASHURIA. Ky familjaritet dhe atmosferë e mirë karakterizoi Poreçin.

Të djelën gjatë një shëtitje të ndërthurrur me shikimin e qytetit vlerësuam dy ditët e kaluara dhe vendosëm që nuk do të kthehemi në shtëpi pa u larë në det. Të djelën pasdite u lamë një orë në det kur të rinjtë të çuditur përcaktuan: - deti qenka me të vërtetë i kripur! Në këtë atmosferë të mirë përshëndetëm Poreçin, dhe të njëjtën kohë vendosëm që edhe vitin e ardhshëm po këtu, të zgjeruar me supervisorë të rinj do të takohemi përsëri me FAMILJEN e madhe.



**IBOLYA UNGHY DHE MIHALY HORVATH**  
supervisorë



# Edhe Ti e dëshiron



**DR. TUMBAS DUSANKA**  
senior manager

Me frymëmarrjen e fundit të verës dhe me korrierët e parë të vjeshtës erdhi edhe dita jonë e suksesit – Success Day i shtatorit në Beograd. Pushimi ynë i verës ishte i shkurtër, por produktiv, dhe këtë e vërteton edhe numri i punonjësve tanë që arritën nivele të reja kualifikimi.

**S**ekreti i suksesit të FLP-s fshihet në marrëdhënien ndërmjet sponsorit dhe bashkëpunonjësit të tij. **Senior manageri Dr. Tumbas Dusanka** dhe **manageri Sinisa Blaskovic**, sponsorja dhe bashkëpunonjësi i tij, ishin drejtuesit e programit të Success Day-t të parë të vjeshtës. Na pëlqeu të gjithëve drejtimi mjeshtror i programit nga Dusica dhe Bosko.

Drejtori rajonal i FLP Serbisë, **Branislav Rajic** bëri një përmbledhje të punës së periudhës së verës. Gjatë muajve të verës punuam me vullnet dhe këmbëngulje, kryem një punë të madhe, hodhëm një hap të madh historik në ndërtimin e rrjetit të distributorëve. Distributorët serb ishin në çdo vend të botës. Kudo që shkuan u pritën mirë dhe e përfaqësuan në mënyrë dinjitoze metodën e suksesshme të punës të rajonit sllavo-jugor.

Programi më i ri motivues **Holiday Rally** solli si rezultat kualifikimin e shumë supervisorëve, assistant managerëve dhe managerëve. Në skenën e Pallatit të Sindikatave i përgëzuan edhe njëherë fituesit e programit motivues dhe u uruam rrugë të mbarë për në Poreç.

Puna në skuadër sjell gjithmonë sukses. Fillon me vendime individuale të cilat ndërthurren në rrjetin e punës në skuadër, duke krijuar me këtë forca të reja shtytëse dhe krijuese. TI je forca

lëvizëse e çdo ngjarjeje dhe njëkohësisht edhe pjesë e skuadrës, pa të cilën gjithë kjo nuk do të funksiononte dot. Forever-i i shpërblen lojtarët e skuadrës që ndodhen në nivele të ndryshme dhe u ofron mundësi për të marrë forca të reja që ta vazhdojnë më fuqishëm ndërtimin e rrjetit të punonjësve. Bashkëpunonjësja jonë **safir managerë Marija Burus** ka qenë dëshmitare e shumë programeve motivuese të cilat gjatë dhjetë viteve të kaluara kanë ndërtuar një rrjet të fortë dhe të sigurt bashkëpunimi. E falenderojmë për leksionin e saj të shkëlqyer dhe dinamik, sllogeni i të cilit ishte: **Edhe Ti e dëshiron dhe mund ta bësh!**

Një nga mësuesit më të mirë të jetës sonë është përvoja, vetëm që ndonjëherë ka çmim tepër të lartë. Përvojat e vërteta dhe të sinqerta që sigurojnë përdoruesit e produkteve të FLP-s dhe mjekët që i përdorin përditë këto produkte, tregojnë një shembull të qartë se si mund të përmirësojmë cilësinë e jetës sonë dhe të të tjerëve. E falenderojmë bashkëpunonjësën tonë **soaring managerë, Dr. Biserka Lazarevic**, e cila e drejtoi me angazhim të plotë këtë pjesë të programit dhe dha këshilla të shkëlqyera në lidhje me atë se si mund të arrihet harmonia ndërmjet njeriut dhe natyrës.

Aftësia jonë e qëndrueshmërisë ruan unitetin e organizmit tonë dhe e bën më rezistent ndaj dëmtuesve të përditshëm të mjedisit. Bimët



**SINIŠA BLAŠKOVIĆ**  
manager

FOTOGRAFOI: DIMITRIJE OSTOJIĆ

# dhe mund ta bësh







mjekësore fituan një përdorim të gjerë në mjekimin e problemeve të ndryshme të funksionimit të organizmit të njeriut. Këto mekanizma pozitive vërtetojnë përvojat e favorshme – të siguruara në jetën e përditshme të përdoruesve dhe gjatë praktikës së mjekëve. Produktet e FLP-s veprojnë mirë në aftësinë e qëndrueshmërisë së njeriut – theksoi në leksionin e tij bashkëpunonjësi ynë **manager Dr. Aleksandar Petrovic.**

Programet motivuese të FLP-s i ndihmuan rrjetndërtuesit e shkëlqyer në arritjen e niveleve të ndryshme dhe të suksesit. Në skenën e Pallatit të Sindikatave përgëzuar **supervisorët, assistant managerët dhe managerët** e rinj të cilët punuan me vullnet gjatë muajve të nxehtë të verës dhe i arritën qëllimet e tyre.

Forca mahnitëse e jetës së **Maja Odzaklijevskaja-s** i vë të gjithë në lëvizje, kurse zëri i saj i bukur që të ngroh shpirtin na pushton zemrat. Ajo është mysafire e përherëshme e aktiviteteve tona. Karizmatizmi i saj është për t'u patur zili. E falenderojmë shumë Maja-n për shfaqjen e saj dhe mendojmë gjithmonë me kënaqësi për të edhe në të ardhmen.

Të gjithë ne jemi drejtuesit e shkollës së jetës dhe zotëruesit e jetës sonë, si dhe shkaktarët më të mëdhenj të disfatave tona. Pothuajse shpërtheu skena, aq energji pozitive rrezatoi bashkëpunonjësi ynë **Milan Pavlovic Mitrovic** i cili është konsumator i kënaqur dhe **manager** i suksesshëm i FLP-s. Secili prej nesh mund të bëhet punonjës i rëndësishëm dhe konsumator i kënaqur produktesh – nëse kemi dëshirë. Programi Forever ofron mundësinë që të mësojmë shumë nga përvojat e të tjerëve, dhe ato që mësojmë t'ua përcjellim edhe të tjerëve gjatë jetës dhe punës sonë të përditshme. Ky proces kurorëzon karrierën tonë të suksesshme.

Si mund të jenë disa aq të suksesshëm, kurse të tjerë jo? Suksesi është rezultati i dëshirës dhe i pikësynimit. Rregullorja e tij përbëhet nga këto hapa: **vendos,**

**mëso, përgatit planin, puno vetëm, puno përditë, beso tek ajo që bën, dhe mos u dorëzo kurrë!** Ai që digjet nga dëshira e palëkundshme, realizimin e të cilës mund ta pengoj vetëm vdekja, do të ketë gjithmonë rezultat dhe do t'i realizojë qëllimet e tij. **Kur e di se përse punon, atëherë "mënyra se si" funksionon vetë!** Zoti **Rex Maughan** përpara tre dhjetëvçarëve hodhi bazat e punës përvojat e të cilës sollën shumë gjëra të bukura në jetën e bashkëpunonjësit tonë **soaring manager, Dr. Predrag Lazarevic.** Sukseset dhe mentaliteti i punës së tij frymëzuan këtë leksion.

Pas një pushimi të shkurtër i mblodhëm në një buqetë punonjësit që në krahasim me periudhën e kaluar e rritën shumë rezultatin e punës së tyre, duke hyrë me këtë në **Klubin e Sundimtarëve.**

Fituesit e programit motivues të blerjes së makinës ishin bashkëpunonjësit tanë senior manager, **Sonja dhe Nebojsa Knezevi.** Përgëzime!

Jeta dhe puna jonë na detyron të krijojmë marrëdhënie të përditshme dhe ndonjëherë edhe mospërputhje mendimesh që rrjedhin nga këto, të cilat janë të pashmangshme gjatë punës. Me zgjidhjen e tyre hapet çdo derë në rrugën drejt suksesit. Por karriera e punonjësve varet nga aftësia e tyre për t'i zgjidhur shpejt dhe mundësisht pa dhembje problemet e ndryshme në radhë të parë me vetveten, pastaj me bashkëpunonjësit dhe ambientin e tij. Këmbëngulja dhe marrëdhëniet e mira njerëzore të treguara gjatë marrjes së vendimeve, veprimeve dhe punës i çon të gjithë drejt suksesit të shumëpritur – tha mysafiri ynë **Dr. Dusan Pavlovic.**

Falenderuam drejtuesit e programit për punën e tyre dhe me dhënien e medaljeve të **assistant supervisorit** u përshëndetëm me mysafirët tanë. Aktivitetin tonë të ardhshëm e organizojmë më 13 tetor në Pallatin e Sindikatave të Beogradit.

**BRANISLAV RAJIC**  
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

## Klubi i Sundimtarëve

Dhjetë  
shpërndarësit  
e parë sipas  
pikëve personale  
dhe të non-  
managerit

# CONQUISTA

## Shpërndarësit më të su



**HUNGARIA**



1. Dominkó Gabriella
2. Szekér Marianna
3. Tóth István dhe Zsiga Márta
4. Nagy Ádám dhe Nagyné Belényi Brigitta
5. Krizsó Ágnes
6. Csuka György dhe Dr. Bagoly Ibolya
7. Geczó Éva Krisztina
8. Tamás János dhe Tamás Jánosné
9. Dobsa Attila dhe Dobsáné Csáki Mónika
10. Miklós Istvánné dhe Tasi Sándor



**SERBIA, MALI I ZI**



1. Mičić Mirjana dhe Harmoš Vilmos
2. Žurka Dragana dhe Žurka Radiša
3. Buruš Marija dhe Buruš Boško
4. Janović Dragana dhe Janović Miloš
5. Nakić Marija
6. Buljan Slobodanka dhe Buljan Stanislav
7. Tomić Sofija dhe Tomić Ljubiša
8. Strboja Jovanka dhe Strboja Radivoj
9. Davidović Svetlana dhe Davidović Mila
10. Hunjevački Jovanka dhe Bunjevački Živojin



# DOR CLUB

ksseshëm të muajit shtator 2007



**KROACIA**



1. Kraljić-Pavletić Jadranka dhe Pavletić Nenad
2. Jurović Zlatko dhe Jurović Sonja
3. Draščić Dušan dhe Draščić Marija
4. Calušić Dubravka dhe Calušić Ante
5. Romić Meszaros Mirjana dhe katić Ivan
6. Vidiček Velimir dhe Vidiček Ivka
7. Lesinger Ivan dhe Lesinger Danica
8. Culjak Marica dhe Culjak Blago
9. Nešić Saša
10. Vukas Božica



**BOSNIA DHE HERCEGOVINA**



1. Dragić Meliha dhe Dragić Dragan
2. Catić Gaibija dhe Catić Munira
3. Babić Mirko dhe Babić Nada
4. Njegovanović Zoran
5. Duran Mensura dhe Duran Mustafa
6. Antić Milica dhe Antić Mičo
7. Stojnić Slavko dhe Stojnić Tonka
8. Naser dr. Nabil dhe Hadžiomerović Naser dr. Nura
9. Medić Stana
10. Dr. Petković Nedeljko dhe Petković Milojka



**SLLOVENIA**



1. Iskra Rinalda dhe Iskra Lučano
2. Bigec Danica
3. Praprotnik Toncka
4. Savski Rajko
5. Batista Ksenija
6. Pekosak Helena
7. Krejci Hrastar Marjeta dhe Hrastar Milan
8. Begić Zemir
9. Kepe Andrej dhe Hofstätter Miša
10. Zajc Simona dhe Mernik Matija



# Të gjithë në rrugën drejt suksesit



## Nivelin e managerit e arritën:

Hodžić dr. Sead  
sponsor: *Smajić Mevludin*

Horváth Tibor dhe Csanaky Tünde  
sponsor: *Iski Béla dhe Iski Béláné*



## Nivelin e assistant managerit e arritën:

Balázs Nikolett  
Balogh Zoltán  
Bodnár Daniela  
Csorba Anett  
Fekete Béla dhe  
Feketéné Nagy Julianna  
Kocsis János dhe

Kocsis Jánosné  
Marečić Dragica  
Molnár Imre dhe  
Molnár Imréné  
Móricz Edit  
Olasz Attila  
Rutár Dalma Laura

Staudinger József  
Steigervald Tímea  
Szegeci Mária  
Tomić Sofija dhe  
Tomić Ljubiša  
Tóth János dhe  
Tóth Jánosné



## Nivelin e supervisorit e arritën:

Antić Milica dhe  
Antić Mićo  
Bajić Bojana dhe  
Bajić Slaviša  
Benke László  
Daróczy Márk  
Dombóvári Zoltán  
Domby Veronika dhe  
Domby József  
Fancsik Ferenc dhe  
Fancsikné Nagy Judit  
Farkas Miklósné dhe  
Farkas Miklós  
Farkasné Kovács Katalin dhe  
Farkas László  
Fekete Ágnes  
Forró Árpádné dhe  
Forró Árpád  
Gáspár Gergely dhe  
Németh Tímea  
Gazder Ferencné  
Hajdú Mihály dhe  
Hajdú Mihályné  
Hariharan Mónika  
Hegedűs Kálmáné

Hegyes Péter  
Hervainé Andrej Ildikó dhe  
Hervai Csaba  
Horváth Norbert  
Iván Gézáné  
Jovanović Nevenka dhe  
Jovanović Vojislav  
Kaczor Antalné dhe  
Kaczor Antal  
Kanovits Róbert  
Karasz György dhe  
Karasz Györgyné  
Karvalyné Miklós Gyöngyi  
Kolozsvári Gábor  
Krajcoviczné Kalydi Erika dhe  
Krajcovicz Pál  
Kucsá Szabolcs Mihály  
Kóródi Sándorné dhe  
Kóródi Sándor  
Lajos Bernadett  
Laskodyová Katarina dhe  
Laskody Milán  
Lőrincz Ágnes  
Marečić Nemanja  
Molnár Judit dhe

Kozma Tibor  
Németh Gyuláné dhe  
